

Tiranë. 05.08.2019

KONTRATË DHURIMI E KUOTAVE TË AKSIONERIT ELBAN HALIL  
DERVISHBEHAJ, DHURUAR AKSIONERES ZHULJETA HALIL VEIZAJ në "REA  
ALBANIA" sh.p.k.

Unë Elban Halil Dervishbehaj, me dëshirë të plotë, dhe të pavesuar dhuroj aksionet e mia prej 30% aksioneres Zhuljeta Halil Veizaj.

Neni 1

PALËT NË KONTRATË

PALA DHURUESE:

1. Elban Dervishbehaj, i biri i Halilit, i datëlindjes 20.06.1975, lindur në Kapaj Fier, dhe banues në Durrës, i pajisur me pasaportën me nr.BR9923643 dhe nr. Personal H5062912A, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

PALA PRANUESE DHURIMI:

2. Zhuljeta Veizaj, e bija e Halilit, e datëlindjes 15.02.1971, lindur në Kapaj Fier dhe banuese në Tiranë, e pajisur me pasaportën BG8149674, me nr.Personal H15215074T, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## NENI 2

### BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në bazë dhe në zbatim të vullnetit të lirë dhe të pavesuar të palëve të përcaktuar në nenin 1 si mësipër.

Kjo kontratë hartohet edhe në bazë dhe për zbatim të:

- a. Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në vecanti të nenit 761, nenit 762 të tij;
- b. Statutin e shoqërisë "REA ALBANIA" sh. P.k
- c. Ligji 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare " dhe në vecanti neni 73 dhe vijues të tij;
- d. Vendimit të Asamblesë Së Ortakëve të Shoqërisë "REA ALBANIA" sh.p.k

## NENI 3

### OBJEKTI

1. Kjo kontratë ka për objekt dhurimin e 30% të vlerës së kapitalit të shoqërisë, që zotëron pala dhuruese Elban Halil Dervishbehaj në kapitalin e shoqërisë "REA ALBANIA" sh.p.k që janë pronë e palës dhuruese dhe të gjitha të drejtave që lidhen me to, nga të cilat pala dhuruese Elban Halil Dervishbehaj i dhuron keto kuota në këtë mënyrë:
2. Pala dhuruese Elban Halil Dervishbehaj i dhuron palës pranuese të dhurimit Zhuljeta Veizaj 30% të kapitalit të shoqërisë që disponon dhe pala pranuese Zhuljeta Veizaj i pranon palës dhuruese 30% të kapitalit të saj në shoqërinë "REA ALBANIA" sh.p.k.

Pala pranuese Zhuljeta Veizaj bëhet aksionere me 100% të kapitalit të Shoqërisë "Rea Albania" sh.p.k.

#### NENI 4 DETYRIMET E PALËVE

##### 1 DETYRIMET E PALËS DHURUESE:

- a. Deklaron se është pronare e 30% të kuotave në shoqërinë "REA ALBANIA" sh.p.k.
- b. Garanton palën dhuruese të pranimit se këto kuota janë të lira nga cdo barrësim dhe detyrim karshi të tretëve dhe për cdo pretendim që mund të ngrenë të tretët për çënimin e pronësisë së palës pranuese të dhurimit, unë jam i gatshëm dhe i detyruar të paraqitem menjëherë me kërkesën e palës pranuese të dhurimit dhe të cdo personi tjetër të tretë, që pretendon mbi këto kuota, para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e saj, si pronare e ligjshme e këtyre kuotave pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

##### 3. DETYRIMET E PALËS PRANUESE TË DHURIMIT;

- a. Pala pranuese ka marrë në dorëzim kuotat, duke mos patur asnjë vërejtje sipas dokumentit ligjor.

##### 4. DETYRIMET DYPALËSHE:

- a. Palët kontraktuese deklarojnë se të gjitha detyrimet e përshkruara më lart dhe të gjitha ato që burojnë nga kjo kontratë dhurimi janë realizuar prej tyre dhe ato nuk kanë asnjë detyrim të ndërsjelltë midis tyre dhe nuk do të ketë asnjë detyrim në të ardhmen.

- b. Palët kontraktuese deklarojnë se kuotat janë marrë në dorëzim nga pala pranuese e dhurimit në gjendjen që janë dhe ato nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me këtë veprim.

#### NENI 6

##### PASOJAT TRANZITORE TË KALIMIT TË AKSIONEVE

1. Pala dhuruese si dhe pala pranuese janë solidarisht përgjegjës ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kësaj kontrate .
2. Përgjegjësia solidare e palës dhuruese dhe e palës pranuese ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kësaj kontrate fillon nga casti i kalimit të kuotave nëpërmjet nënshkrimit të kontratës dhe përfundon me regjistrimin e këtij kalimi në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT" i ndryshuar.

#### NENI 7

##### EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronësisë së kuotave nga pala dhuruese tek pala pranuese në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate përfundon me regjistrimin e kësaj kontrate pranë QKB dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9723, dt.03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.
2. Kalimi i kuotave sipas kësaj kontrate regjistrohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9723, dt. 03.05.2007, "Për QKB" i ndryshuar.
3. Regjistrimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni ka efekt deklarativ.

NENI 8  
DOKUMENTE TË BASHKËLIDHURA

1. Kësaj kontrate i bashkëlidhen dhe konsiderohen si pjesë e pandashme dokumentet si më poshtë vijojnë:

- a. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "REA ALBANIA" sh.p.k
- b. Dokumentet identifikuese të palëve.

NENI 9  
DISPOZITAT E FUNDIT

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët kontraktuese, pala dhuruese Elban Dervishbehaj zhvishet nga pronësia e 30% të kapitalit të shoqërisë dhe pronare e tyre bëhet Zhuljeta Veizaj.
2. Zhuljeta Veizaj bëhet zotëruese në 100% pjesë të kapitalit themeltar e shoqërisë "REA ALBANI" sh.p.k.
3. Kontrata e dhurimit u hartua në 3 kopje të barazvlefshme, nga një për secilin aksioner dhe një për regjistrimin në QKB.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

PALA PRANUESE E DHURIMIT

ELBAN DERVISHBEHAJ

ZHULJETA VEIZAJ

Elban Dervishbehaj

Zhuljeta Veizaj  
Z. Veizaj

